

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

PËR
MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR TRAJTIMIN,
SHFRYTËZIMIN, SHITJEN, EKSPORTIN, IMPORTIN,
ADMINISTRIMIN DHE TRANSPORTIN E MATERIALIT
DRUSOR DHE TË PRODHIMEVE JODRUSORE PYJORE,
KATEGORIZIMIN E RRUGËVE AUTOPYJORE, PËRDORIMIN
DHE STANDARDET TEKNIKE TË TYRE, SI DHE KRITERET
PËR SHËNIMIN DHE ETIKETIMIN E PRODHIMEVE DRUSORE
DHE PËR PRERJET SHFRYTËZUESE NË SIPËRFAQET ME
FILIZËRI TË ZHVILLUAR MBI LARTËSINË OPTIMALE

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin (rastet e lejuara), importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimi i rrugëve autopsyjore, përdorimi dhe standardet teknike të tyre.

Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” në nenin 26, pikat 1 dhe 3, autorizon Këshillin e Ministrave, që me propozim të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit të përcaktojë rregullat për shfrytëzimin e prodhimeve jodrusore pyjore e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET). Neni 27, autorizon Këshillin e Ministrave, që me propozim të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit të përcaktojë rregullat për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin (rastet e lejuara), importin, administrimin dhe transportin e

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale.”

materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimi i rrugëve autopsyjore, përdorimi dhe standardet teknike të tyre, ndërsa neni 32, pika 1, shkronjat “ç” dhe “dh”, autorizon Këshillin e Ministrave, që me propozim të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit të përcaktojë kriteret e shënjitimit me bojë të paheqshme dhe vendosin etiketa në prodhimet e materialit drusor të subjekteve që kryejnë prerje shfrytëzuese në fondin pyjor publik dhe privat dhe kriteret teknike të prerjeve në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale.

Nga ana e Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Natyrës dhe pyjeve në dakordësi me Drejtorinë e Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, duke qenë se procesi i shfrytëzimit të materialit drusor, prodhimeve jodrusore pyjore e BMET, shtija, transporti, eksporti, importi janë të ndërlidhura si procese dhe koordinohen nga struktura të njëjta të bashkive dhe ministrisë përgjegjëse për pyjet kemi hartuar këtë draft VKM duke përfshirë autorizimet ligjore sa më sipër. Po kështu edhe rrugët autopsyjore si infrastrukturë mbështetëse e gjithë procesit u mendua të jetë e përfshirë në të.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi që paraqesim për shqyrtim dhe miratim është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projekt-akteve për vitin 2025. Gjithashtu projektvendimi është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave për fushën e veprimtarisë që mbulon Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Miratimi i këtij projektvendimi kontribuon gjithashtu në zbatimin e masave të parashikuara në Dokumentin e Politikave për Pyjet në Shqipëri.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale.”

Projektvendimi synon të përcaktojë dhe të miratojë rregullat për shfrytëzimin e prodhimeve jodrusore pyjore e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET). Të përcaktojë rregullat për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin (rastet e lejuara), importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, si dhe kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre dhe të përcaktojë kriteret e shënimit me bojë të paheqshme dhe vendosjen e etiketave në prodhimet e materialit drusor të subjekteve që kryejnë prerje shfrytëzuese në fondin pyjor publik dhe privat si dhe kriteret teknike të prerjeve në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale.

Projektvendimi që paraqesim për shqyrtim do të kontribuojë në rregullimin e shfrytëzimit të materialit drusor, BMET e prodhimeve të tjera jodrusore pyjore duke gjykuar mbi përfitimet e mëdha që ka shoqëria jonë nga to dhe që kërkojmë edhe shërbime të domosdoshme, gjithnjë mbi bazën e parimit të zhvillimit e të menaxhimit të qëndrueshëm të Fondit Pyjor e Kullosor Kombëtar. Gjithashtu synojmë të rregullojmë dhe mënyrën e administrimit, transportit, eksportit e importit të këtyre produktve duke i standartizuar si nga ana proceduriale ashtu edhe ligjore.

Objektivat e këtij projektvendimi janë:

1. Hartimi dhe miratimi i akteve, rregullave dhe dokumentacionit për zbatimin e ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 "Për pyjet", i ndryshuar;
2. Rregullimet teknike dhe ligjore lidhur me trajtimin dhe shfrytëzimin e pyjeve për material drusor dhe prodhimeve pyjore jodrusore, bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET), nisur nga zhvillimi i qëndrueshëm në sektorin e pyjeve, duke rregulluar marrëdhëniet në këtë sektor, rregullime që kanë ndikim thelbësor në cilësinë e mjedisit natyror;
3. Krijimi i një pakete bazë (sistemi) dokumentacioni teknik e ligjore për aktivitetet në pyje, duke patur parasysh pikësëpari ruajtjen dhe përmirësimin e potencialeve prodhuese, të ekuilibrave të mjedisit natyror, biodiversitetit, burimeve gjenetike, regjimit hidrik, etj.;

Relacion shpjegues për projektvendimin: "Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale."

4. Rritja e të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore ose për strukturat përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor, duke u mundësuar atyre të ri-investojnë në mirë administrimin, rehabilitimin, rigjenerimin, shtimin dhe monitorimin e fondit pyjor;
5. Rregullimi i procesit të administrimit dhe shfrytëzimit të pyjeve, në mënyra dhe intensitete të tilla që të ruajnë larminë e tyre biologjike, prodhimtarinë dhe kapacitetet ripërtëritëse, për të përmbushur tani dhe në të ardhmen funksionet ekologjike, ekonomike dhe shoqërore, pa shkaktuar dëme në ekosistemet e tjera.
6. Rregullimi i procesit të prerjes, transportit, shitjes apo edhe import-eksportin e materialit drusor/pyjor jodrusor dhe BMET.
7. Standardizimi teknik i rrugëve pyjore si infrastrukturë e domosdoshme në fondin pyjor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me kuadrin ligjor Kombëtar të Sektorit Pyjor dhe hartohet në zbatim të nenit 26, pikat 1 dhe 3, nenit 27, pika 4 dhe nenit 32, pika 1, shkronjat “ç” dhe “dh”, të Ligjit 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon transpozimin e *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi në përmbajtje të tij konsiston në përcaktimin e rregullave për shfrytëzimin e prodhimeve jodrusore pyjore e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore (BMET), rregullat për trajtimin,

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale.”

shfrytëzimin, shitjen, eksportin (rastet e lejuara), importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimi i rrugëve autopsyjore, përdorimi dhe standardet teknike të tyre, kriteret e shënimit me bojë të paheqshme dhe vendosin etiketa në prodhimet e materialit drusor të subjekteve që kryejnë prerje shfrytëzuese në fondin pyjor publik dhe privat dhe kriteret teknike të prerjeve në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale, dhe ka të përcaktuar 5 krerë dhe 11 nene:

Kreu I, kemi të parashtruar qëllimin e projektvendimit dhe përkufizimet, për këtë qëllim. Ky kre është i ndarë në 2 nene.

Kreu II, janë përcaktuar rregullat e trajtimit dhe shfrytëzimit të lëndës drusore, prodhimeve jodrusore pyjore dhe BMET, ky kre ka 5 nene. Neni 3, rregullon trajtimin dhe shfrytëzimin e lëndës drusore, neni 4, trajtimin dhe shfrytëzimin e sipërfaqeve me filizëri të zhvilluar, neni 5, përcakton marketimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore, neni 6, përcakton rregullat për dorëzimin e ngastrave apo nënngastrave për trajtim dhe shfrytëzim të materialit drusor dhe kolaudimin e tyre, neni 7, trajtimi dhe shfrytëzimi i prodhimeve jodrusore pyjore e BMET.

Kreu III, janë të përcaktuara si bëhet shitje e materialit drusor dhe prodhimeve jodrusore pyjor, BMET, transporti, eksporti (kur lejohet) dhe importi. Ky kre ka 2 nene, neni 8, përcakton si do bëhet shitja e materialit drusor dhe prodhimeve jodrusore pyjore e BMET, do bëhet pas miratimeve përkatëse nga ministria përgjegjëse, strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki/zonat e mbrojtura. Neni 9, përcakton se transporti, eksporti (në rastet e lejuara) dhe importi i materialit drusor dhe prodhimeve jodrusore pyjore dhe BMET, bëhet vetëm pasi të pajisen me vërtetim transporti dhe certifikatë origjine.

Kreu IV, përcaktohen kategoritë e rrugëve autopsyjore, si përdoren dhe standartet e tyre. Ky kre ka 2 nene. Neni 10, përcakton kategoritë e rrugëve autopsyjore dhe përdorimin e tyre dhe neni 11, jep rregullat e hollësishme për ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve autopsyjore.

Relacion shpjegues për projektvendimin: "Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standartet teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale."

Kreu V, është kreu ku përcaktohen dispozita e fundit. Në të cilën shfuqizohen nr. 438, datë 08.06.2016, i Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore”, i ndryshuar si dhe Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 2, datë 3.3.2017, “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore, për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim, sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”.

Duke qenë se nuk kemi autorizim ligjor për daljen e një udhëzimi të ri, kemi hartuar Aneksi 1, për kërkesat teknike të caktimit të nënngastrave, ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje kulturore, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje, Aneksi 2, me projektin teknologjik tip, Aneksi 3, me kriteret e teknike të grumbullimit të BMET dhe Aneksi 4, për standartet e rrugëve autopyjore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen bashkitë, organet kontrolluese dhe inspektuese të ngarkuara me ligj, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashkëpunim me sektorin e legjislacionit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe është konsultuar me të gjitha strukturat e vartësisë të ministrisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopyjore, përdorimin dhe standartet teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale.”

Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, pasi e gjithë veprimtarisë do të kryhet nga strukturat për pyjet në bashki dhe strukturat e tjera përgjegjëse për pyjet dhe si rrjedhim kjo kosto është pjesë e shpenzimeve të pagave të punonjësve.

MINISTRI

Mirela KUMBARO FURXHI



Konceptoi: A. Seci, Specialist
Y. Hoxha, Përgjegjës Sektori
A. Kaso, Specialist
I. Çela, Përgjegjës Sektori
Miratoi: K. Marika, Drejtor
E. Tarelli, Drejtor
A. Karaja, Drejtor i Përgjithshëm
Konfirmoi: L. Beqiraj Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm

Data, 19.6.2025

Relacion shpjegues për projektvendimin: “Për miratimin e rregullave për trajtimin, shfrytëzimin, shitjen, eksportin, importin, administrimin dhe transportin e materialit drusor dhe të prodhimeve jodrusore pyjore, kategorizimin e rrugëve autopsyjore, përdorimin dhe standardet teknike të tyre, si dhe kriteret për shënimin dhe etiketimin e prodhimeve drusore dhe për prerjet shfrytëzuese në sipërfaqet me filizëri të zhvilluar mbi lartësinë optimale.”